

VENDIM
Nr.174, datë 19.2.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË
LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “JUSTINIANI I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 pika 2 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare private “Justiniani I”, me seli në Tiranë, të programit të studimit, të ciklit të parë, me kohë të plotë, të Fakultetit të Diplomacisë.

2. Kohëzgjatja e programit të studimit, të ciklit të parë, të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë 3 vite. Në përfundim të tij lëshohet “Diplomë e nivelit të parë”, (DNP), në diplomaci.

3. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare private “Justiniani I”, të programit të studimit të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në fushën e drejtësisë, i cili do të realizohet me, së paku, 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite. Në përfundim të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të dytë”, (DND), në drejtësi.

4. Hapjen, pranë shkollës së lartë universitare private “Justiniani I”, të programit të studimit “Master i nivelit të parë”, në degën “Jurist administrate”. Ky program studimi do të realizohet me, së paku, 60 kredite e me kohëzgjatje normale 1 vit. Në përfundim të këtij studimi lëshohet diplomë “Master i nivelit të parë” (MNP) në “Jurist administrate”.

5. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit nga personel akademik, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

6. Shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 1, 3 e 4 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të veprimtarisë mësimore, lejen përkatëse, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

7. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

8. Shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” duhet t’u nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

9. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha